



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

KONTRATA

Numri i kontratës: 101-22-4046-2-3-5 /C79

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në një rën anë;
dhe

HYMERI ELEVATORS,L.L.C, Prishtinë, Rr. Ahmet Krasnqi, Tregtia C2, H8, Nr. 7A; E-mail: *info@hymeri-kleemann.com*; Tel +383 49 75 75 75 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike kornizë për:

Mirëmbajtja mujore, riparimi i liftave në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me numër prokurimi: **101-22-4046-2-3-5 (KU101 22 020 235)**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Mirëmbajtja mujore, riparimi i liftave në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës**

1.2 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e kontratës: **19.05.2022** dhe përfundon më: **18.11.2022**.

1.3 Afati kohor i performancës nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj nga data nënshkrimit të kontratës.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbuloohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi.

3.2 Vlera totale e parashikuar e kontratës është: **5,000.00 € (Me fjalë: pesë mijë euro)**.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Çmimet janë dhënë për një njësi, kontratë kornizë me peshim. Sipas RRUOPP, Neni 56.15 "Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%)".

Çmimi i ofruar me peshim për njësi është: 2,480.30 €

Pagesa bëhet në bazë të çmimeve të ofruara pa peshim.

3.3 Çmimet për njësi janë fikse dhe nuk do t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën e detyrimeve në baza mujore, pas kryerjes së shërbimeve.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve dhe shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *furnizimeve (shërbimeve)*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë të gjitha shërbimet (dhe furnizimet) brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *shërbimeve (dhe furnizimeve)* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykatë (shih KVK)* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.



KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	<ul style="list-style-type: none"> Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	<ul style="list-style-type: none"> Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve	8	<ul style="list-style-type: none"> Mirëmbajtja, riparimi dhe ndërrimi i pjesëve parashihet që të jetë përmes marrëveshjes së plotë duke përfshirë të gjitha shpenzimet e transportit si dhe shpenzimet e personelit. Mirëmbajtja, duhet të realizohet së paku dy herë brenda muajit, ndërsa A.K. për riparimet e pjesëve do të kërkojë nga Operatori Ekonomik intervenim sa herë që ka nevojë (në rast defekti duke mos llogaritur çmim shtesë për shërbimet e ofruara). OE obligohet të mbajë evidencë duke e nënshkruar nga të dyja palët. Në rast prishje të intervenohet brenda dite pas lajmërimit të prishjes nga persona të autorizuar të Kuvendit. Të gjitha pjesët e ndërruara duhen të jenë të njëjta me pajisjet ekzistuese ose kompatibil me sistemin. AK ka të instaluar 2 (dy) lifta elektrike. Në kuadër të mirëmbajtjes përfshihet : Inspektimi i i punëve të të gjitha pajisjeve të sigurisë, posaçërisht punës së pajisjeve të sigurisë të frenave të sistemit ngasës, pajisjes për pranim, kufizuesit të shpejtësisë, kontaktorëve të skajshëm dyerve dhe dorëzave të mbylljes; Inspektimi i litarëve bartës dhe lidhjes së tyre me kabinë dhe kundër peshës; Inspektimi i forcës tërheqëse e cila formohet nga fërkimi; Inspektimi i izolimit të qarqeve të rrymës dhe lidhja e tyre me tokëzimin; Pastrimi dhe lubrifikimi i pajisjeve të ashensorëve; Vërtetimin e rregullsisë së punës së ashensorit nga një stacion në tjetrin përgjatë linjës në të dy drejtimet; Inspektimi i rregullsisë së pajisjes komanduese dhe motorit Gjatë kohëzgjatjes së ekzekutimit të kontratës është e nevojshme që OE të bëjë :

		Riparimi i bobinës ekzistuese sipas nevojës <ul style="list-style-type: none"> Mirëmbajtja e Liftit Panoramik (prodhim italian i ELEMOL) mund të realizohet deri në 6 muaj Mirëmbajtja e Liftit elektrik në Qendër (ASTES) mund të realizohet deri në 6 muaj
Parimet të përgjithshme të pagesave	12	<ul style="list-style-type: none"> Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas kryerjes së shërbimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se shërbimet janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë.
Siguria e ekzekutimit	8	<ul style="list-style-type: none"> Vlera e sigurisë së ekzekutimit 10% i vlerës se parashikuar të kontratës për kohëzgjatjen prej 7 muaj pas nënshkrimit të kontratës
Kualiteti i kontrollit	9	<ul style="list-style-type: none"> Të gjitha pjesët e ndërruara duhen të jenë të njëjta me pajisjet ekzistuese ose kompatibil me sistemin.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	13.1	<ul style="list-style-type: none"> Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 13.1.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedurë gjyqësore	13.2	<ul style="list-style-type: none"> Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.

Shënim:

- Kontratës i bashkëngjitet oferta financiare e operatorit ekonomik dhe kopja e sigurisë së ekzekutimit

Për Autoritetin Kontraktues KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS		Për Operatorin Ekonomik HYMERI ELEVATORS, L.L.C	
Emri:	Xhemail Halili	Emri:	Zonel Gasul
Pozita:	Drejtor i Drejtorisë për Prokurim	Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	19.05.2022	Data:	19.05.2022
Vula:		Vula:	






Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Nr. i Prokurimit: 101-22-4046-2-3-5 dhe Nr. i Brendshëm: KU101 22 020 235 Titulli: Mirëmbajtja mujore, riparimi i liftave në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Përshkrimi i çimit

Nr	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH	Peshimi %	TOTALI (me TVSH)	Emri i prodhuesit për produktin e ofruar (të plotësohet nga operatori ekonomik)
I. Furnizimi me pjesë rezervë							
1	Kontaktorë telemekanik LCI, D 65	copë	1	50.00	70	35.00	Telemacanique
2	Kontaktorë telemekanik LCI, D 25	copë	1	40.00	70	28.00	Telemacanique
3	Moduli furnizues 24V, MLC	copë	1	25.00	30	7.50	Microlift
4	Modul rele 1x6	copë	1	10.00	30	3.00	Microlift
5	Adapter për kolektorë	copë	1	5.00	70	3.50	Arkel
6	Prizë magnetike bistabil, kod BER03300	copë	1	5.00	30	1.50	Arkel
7	Prizë magnetike, kod STE 03400	copë	1	5.00	30	1.50	Bistabil
8	Kufitarët	copë	1	5.00	70	3.50	Pizzato
9	Stop Emergjent	copë	1	10.00	30	3.00	Metroplast
10	Sajla e derës	m	1	10.00	30	3.00	Celsan
11	Siguresa Thikore	copë	1	10.00	70	7.00	Eti
12	Pllaka BMC 3000	copë	1	200.00	70	140.00	MLC Croatia
13	Moduli për pranim të sinjaleve	copë	1	15.00	30	4.50	MLC Croatia
14	Displej në kabinë	copë	1	35.00	70	24.50	Genemek
15	Displej në thirrje të jashtme	copë	1	30.00	70	21.00	Genemek
16	Rrëshqitës të kabinës 16mm	copë	1	8.00	30	2.40	Selkas
17	Senzorët per H/M te deres me shirit	copë	1	175.00	70	122.50	Weco
18	Rrëshqitës të kundërpeshës 9mm	copë	1	7.00	70	4.90	Selkas
19	Butonë	copë	1	30.00	70	21.00	Genemek
20	Bobina	copë	1	25	30	7.50	Philips
21	Vaj për reduktorë	Lit.	1	10	70	7.00	Ina



22	Motorri i dyerve te kabines	copë	1	200	30	60.00	Merih
23	Pllaka elektronike e dyerve automatike	copë	1	200	30	60.00	Arkel
24	Furnizimi dhe nderrimi i pulexhes ndihmese te motorrit	copë	1	150	70	105.00	Akis
25	Furnizimi dhe instalimi i rregullatorit te shpejtesis	copë	1	200	70	140.00	Metroplast
26	Furnizimi dhe instalimi i mekanizmit te deres automatike	copë	1	220	70	154.00	Metroplast
27	Gersheret e dyerve automatike	copë	1	220	70	154.00	Merih
28	Furnizimi dhe instalimi i rreshqitesave te dyerve	copë	1	30	70	21.00	Metroplast
29	Furnizimi dhe instalimi i rollerve te dyerve	copë	1	40	30	12.00	Merih
30	Kontakti i dyerve automatike-qark sigures	copë	1	50	30	15.00	Merih
31	Vinklimi i bobines se frenave	copë	1	150	70	105.00	Sharr
32	Mbushja / mbeshqellja e gurtneve te motorrit	copë	1	70	70	49.00	Glog
33	Rrypi i dyerve te kabines	copë	1	150	70	105.00	Merih
34	Transformator	copë	1	25	70	17.50	Eti
35	Ridrejtues	copë	1	10	70	7.00	Eti
36	Drita	copë	1	10	30	3.00	Eglo
37	Senzorët e dycerëve	copë	1	20	70	14.00	Fermator

Totali me TVSH, I - Furnizimi me pjesë rezervë (1-37)

1473.30

Nr	Pershkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH	Peshimi %	TOTALI (me TVSH)	N/a
----	------------	---------------	-------	-------------------------	-----------	------------------	-----


II. Mirëmbajtja dhe Riparimi

1	Riparimi i pllakës elektronike-Lift Kontroller	copë	1	120	30	36.00	N/a
2	Riparimi motorit asinkron trefazor 5.5 kW	copë	1	350	70	245.00	N/a
3	Riparimi bobinës ekzistuese	copë	1	180	30	54.00	N/a
4	Mirëmbajtja e Liftit Panoramik (prodhim italian i ELEMOL)	muaj	6	80	70	336.00	N/a
5	Mirëmbajtja e Liftit elektrik në Qendër (ASTES)	muaj	6	80	70	336.00	N/a

Totali me TVSH, II- Mirëmbajtja dhe Servisimi (1-5)

1007.00

Kategoria	Rekapitulim i çmimit të ofertës	Totali (ME TVSH)
I (1-37)	Furnizimi me pjesë rezervë	1,473.30
II (1-5)	Mirëmbajtja dhe Riparimi	1,007.00





TOTALI I PËRGJITHSHËM (I+II) (ME TVSH) NË EURO	2,480.30
--	----------

Shënim:

Operatorë ekonomike duhet t'i japin çmimet reale të tregut për produktet (mallin) e ofruar.
Çmimet jo-normalisht të ulëta dhe çmimet më të larta se çmimet reale të tregut do të trajtohen në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik.

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK

EMRI I KOMPANISË	HYMERI ELEVATORS L.L.C.
ADRESA E PLOTË	
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI	ZENEL GASHI
POZITA	MENAXHER
NËNSHKRIMI	
DATA	13.05.2022
VULA	



Për: KUVENDI I KOSOVËS
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: HYMERI ELEVATORS L.L.C, Rr. Ahmet Krasniqi, Tregtia C2, H8 Nr. 7A, Prishtinë
(në vazhdim "operatori ekonomik")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: MIRËMBAJTJA MUJORE, RIPARIMI I LIFTAVE NË NDËRTESËN E KUVENDIT
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Numri i prokurimit: 101-22-4046-2-3-5 (nr. i brendshëm: KU101 22 020 235)

SIGURIA E EKZEKUTIMIT Garancion

Nr.Serik i polices: 156/22

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;
DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e Tenderit;
DHE NGASE NE jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë-nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **500.00 (pesë qind Euro)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **500.00 Euro** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri është e vlefshme 214 ditë prej 19.05.2022 deri më 18.12.2022

Kompania e Sigurimeve "EUROSIG" Sh.a.
Rruga "2 Korriku", Nr.4, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data: 19.05.2022

